



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës me datën 01.02.2021 merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për shënimin e 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1 Z. **Afrim Namani**, Drejtor për Arsim - Kryesues i këshillit
 - 1.2 Z. **Shkelzen Xhaferi**, Shef i kabinetit të kryetarit – anëtar
 - 1.3 Z. **Xhavit Mehmeti**, Zyrtar i komunës – anëtar
 - 1.4 Z. **Islam Latifi**, Drejtor për Shërbime Publike - anëtar
 - 1.5 Z. **Driton Vërbovci**, DKRS – anëtar
 - 1.6 Përfaqësuesit e tri Shoqatave të Luftës së UÇK-së: SHFD, SHIL dhe OVL, – anëtarë
2. Shënimi i ditës së Pavarësisë do të bëhet më 17 shkurt 2021 në Sallën e QK "Hasan Prishtina" në Vushtri.
3. Mbledhjet e Këshillit Organizativ do t'i thërret dhe kryesoj Kryesuesi i Këshillit organizativ.
4. Këshilli organizativ përmes kryesuesit të Kuvendit të Komunës do të thërras seancë solemne të kuvendit të komunës për shënimin e kësaj dite.
5. Këshilli organizativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të përgatis ftesat dhe dërgoj për pjesëmarrje në këtë manifestim si dhe ndërmerr të gjitha veprimet tjera të nevojshme për organizim të shënimit në mënyrë sa më solemne të kësaj date të rëndësishme.
6. Kryesuesi i KO do të raportoj te kryetari i komunës lidhur me përgatitjet për këtë manifestim si dhe mbarëvajtjen, pas përfundimit të shënimit të kësaj date.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- Arkivit të Sekretarisë.



Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 151/21

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 10.02.2021

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 67 "P" dhe "g" të Statutit të Komunës, nenit 10 të Rregullores (KKV) Nr.277/20, dt. 30.12.2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PER FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES

1. Formohet komisioni vlerësues për shqyrtim të kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një vit, të parashtruar në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
 - 1.1 Isa Latifi, kryesues
 - 1.2 Shqipe Gashi, anëtare
 - 1.3 Fatmir Feka, anëtar
3. Komisioni, me rastin e shqyrtimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, do të zbatoj dispozitat e Rregullores (KKV) Nr.277/20, dt. 30.12.2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Komisioni ka mandat dy vjet nga dita e marrjes së këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 191/21

Nr. i fq. / Br. sh

Data: / Datum 23.02.2021

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për përgatitje të Draft Strategjisë Komunale Kundër Dhunës në Familje për periudhën 2021-2024 në këtë përbërje:
 - 1.1 Znj. **Remzije Zekolli**, kryesuese e komisionit
 - 1.2 Z. **Qemajl Hasani**, anëtar
 - 1.3 Znj. **Kimete Mehana**, anëtare
 - 1.4 Z. **Bashkim Asllani**, anëtar
 - 1.5 Znj. **Vildane Mulaku**, anëtare
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të përgatis Draft Strategjisë Komunale Kundër Dhunës në Familje për periudhën 2021-2024 dhe dërgoj (përmes sekretarisë së kuvendit) për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.